

Erind Merkuri ka përfunduar studimet e larta për drejtësi në vitin 2007 dhe në vitin 2011 ka përfunduar Masterin e Nivelit të Dytë pranë Universitetit të Tiranës. Në vitin 2016 ka marrë Gradën Shkencore “Doktor i Shkencave në të Drejtën Publike/Kushtetuese”, pasi mbrojti dizertacionin me temë “Aspekte procedurale të gjykimit kushtetues”.

Që nga viti 2008 ka qenë lektor i së Drejtës Kushtetuese në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës dhe që nga viti 2009 ka ushtruar edhe profesionin e avokatit, duke qenë prej vitit 2019 e vijues pjesë e Studios Ligjore “Meksi Law & Consulting”. Gjatë karrierës si avokat, ka qenë i specializuar në dhënien e konsulencës dhe përfaqësimit në mosmarrëveshjet me natyrë kushtetuese, administrative, civile, tregtare dhe pronësinë intelektuale.

Gjithashtu, ai ka qenë që nga nëntori 2016 anëtar i Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes për Trupën e Nivelit të Lartë Drejtues në Shërbimin Civil dhe që nga dhjetori 2020, ka qenë edhe anëtar i Komisionit Disiplinor pranë Dhomës së Përmbauesve Gjyqësorë Privatë. Ka qenë pjesëmarrës në shumë projekte pranë organizatave ndërkombëtare si OSBE, UNDP, AICS, IOM etj.

Me vendimin nr.69, datë 25.7.2024 të Kuvendit të Shqipërisë, është emëruar si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e avokatëve.

Here is the translated text in English:

Erind Merkuri completed his higher education in law in 2007 and obtained a Second Level Master's degree at the University of Tirana in 2011. In 2016, he was awarded the Scientific Degree of “Doctor of Science in Public/Constitutional Law” after successfully defending his dissertation on “Procedural Aspects of Constitutional Adjudication”

Since 2008, he has been a lecturer in Constitutional Law at the Faculty of Law, University of Tirana, and since 2009, he has also practiced as an attorney. Since 2019, he has been a part of the law firm “Meksi Law & Consulting”. Throughout his career as an attorney, he has specialized in providing consultancy and representation in disputes related to constitutional, administrative, civil, commercial, and intellectual property law.

Additionally, since November 2016, he has been a member of the National Selection Commission for the Senior Civil Servants in the Civil Service, and since December 2020, he has also served as a member of the Disciplinary Commission at the Chamber of Private Bailiffs. He has participated in numerous projects with international organizations such as OSCE, UNDP, AICS, IOM, among others.

By the decision no.69, dated 25.7.2024 of the Assembly of Albania, he was appointed as a member of the High Prosecutorial Council from the ranks of the attorneys.